



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:205312

Datë: 20.09.2024

Numri i dokumentit: 06188724

PKR.nr.171/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË / DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Naser Foniqi, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita Hoxha Koleci, në çështjen penale të akuzuarit Q.B., i akuzuar për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës – në vijim KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr.140/2024, të datës 11.09.2024, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 18.09.2024, në të cilin ish-in të pranishëm prokurori i shtetit Dulina Hamiti dhe i akuzuari Q.B., me mbrojtësin e tij av. Visar Rrecaj me autorizim, me datë 18.09.2024 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari Q.B., i biri i Q.I dhe Z., e vajzërisë Gj., i lindur me datë ..., në fshatin D., Komuna Skënderaj, tani me banim në F.K., rruga "...", Objekti ..., hyrja ..., numër ..., me numër personal ..., ka të kryer Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, i pa martuar, i pa punë - i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, **gjendet nën masën e paraburgimit nga data 18.07.2024**,

ËSHTË FAJTOR

S e p s e: me datë 18.07.2024, rreth orës 20:50, Policia e Kosovës / Stacioni Policor në Fushë Kosovë, gjatë patrullimit në rrugën "...“ në Fushë Kosovë ka ndaluar tani të akuzuarin Q.B., e gjatë kontrollit në trupin e tij dhe në motoçikletën të cilën e ka drejtuar, ka gjetur dhe sekuestruar substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë të përgjithshme prej 24.17 gram, e më pas policia ka vazhduar kontrollin në banesën ku jeton tani i akuzuari, në rrugën "...“ në Fushë Kosovë, e në dhomën e tij të gjumit ka gjetur sasinë e substancës narkotike të llojit marihuanë në peshë prej 0,56 gram, e cila i është i është sekuestruar nga policia,-

- me këto veprime, ka kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve: 2; 17; 21; 38; 42; 43; 69; 70; 71; 72, par. 1, nënpar. 1.4; 79; 267 par. 1 dhe 5 të KPRK dhe 364 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale – në vijim KPP, të akuzuarit, i shqipton:

DËNIM ME GJOBË DHE DËNIM ME BURGIM

- **Dënim me gjobë në shumë prej tremijë (3000) €**, dhe
- **Dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti**, të cilat dënime do të ekzekutohen pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.
- Dënimin me gjobë si më lart, i akuzuari mund ta paguaj deri në gjashtë këste.
- Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata do t'i caktoj të dënuarit një ditë burgimi për 20 € të gjobës.
- Në dënimin e shqiptuar me burgim, të akuzuarit si më lart i llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit **prej datës 18.07.2024**.
- Të akuzuarit Q.B., i vazhdohet masa e paraburgimi deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar me këtë aktgjykim.
- **Nga i akuzuari Q.B., konfiskohet dhe shkatërrohet apo asgjësohet substanca narkotike e llojit “Marihuanë” në peshë të përgjithshme prej 24.73 gram, e përdorur për kryerjen e veprës penale.**

A R S Y E T I M I

Pas kallëzimit penal të Policisë së Kosovës/Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë / Sektori Rajonal në Prishtinë nr. 2024-AE-0836, të datës 19.07.2024, Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën PP.I.nr.140/2024, të datës 11.09.2024, ka akuzuar të pandehurin Q.B., për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 18.09.2024, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari Q.B. është deklaruar fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar, duke shtuar se është penduar dhe nuk do ta përsëris më veprën penale, duke i propozuar gjykatës ta aprovoj marrëveshjen për pranimin e fajësisë, edhe pse duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të familjes së tij, gjoba është mjaft e madhe dhe e vështirëson gjendjen materiale të familjes.

Sa i përket pranimit të fajësisë nga i akuzuari, prokurori i shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi që pranimi i fajësisë është bërë më vullnetin e plotë të tij, konform dispozitave ligjore dhe marrëveshjes për pranimin e fajësisë si dhe gjendjes faktike të përshkruar në aktakuzë, duke shtuar se meqenëse i akuzuari e ka pranuar fajësinë, sa i përket çështjes së paraburgimit ja lë në diskrecion gjykatës.

Edhe mbrojtësi i të akuzuarit ka deklaruar se e mbështet deklarinimin e të mbrojturit të tij dhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë, pasi që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë

vullnetare, pa presion, duke u konsultuar mjaftueshëm me mbrojtësit, si dhe i ka propozuar gjykatës që marrëveshjen ta aprovoj dhe ta vlerësoj vlerën e gjobës dhe ndarjen e saj në këste, ndërsa sa i përket propozimit për vazhdimin e paraburgimit dhe pas deklarimit të prokurores së shtetit që këtë çështje ia lë gjykatës, mbrojtësi ka kërkuar që masën e paraburgimit ndaj të mbrojturit të tij ta heq menjëherë, për faktin se kanë pushur shkaqet për të cilat është caktuar dhe vazhduar kjo masë, përkatësisht jemi në fazën pas shqyrtimit dhe gjykimit dhe i mbrojturi i tij i ka mbajtur dy muaj, që i bie se i kanë mbetur edhe 10 muaj, kështu që nuk ka arsye që të tentoj të shmanget apo të fshihet nga ekzekutimi i dënimit.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pranimit të fajësisë nga i akuzuari Q.B., kryetari i trupit gjykues me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë dhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi është bindur se i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, se ky pranim është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, se ky pranim nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimit apo premtimit si dhe është mbështetur në faktet që përmban aktakuza e cila nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike. Pastaj, kryetari i trupit gjykues ka vendosur që marrëveshja për pranimin e fajësisë PP.I.nr.140/2024 e datës 09.09.2024, e lidhur në mes të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Zejnulla Gashi dhe prokurores së shtetit Dulina Hamiti në njërën anë dhe të akuzuarit Q.B. me mbrojtësin e tij av. Visar Rrecaj, në anën tjetër, të vendoset në shkresat e lëndës PKR.nr.171/2024.

Po ashtu, edhe nga provat materiale të cilat ndodhen në shkresat e lëndës, përkatësisht: Vërtetimet mbi sekuestrimin e sendeve të datës 18.07.2024, me numër rasti 2024-AE-0836; lista e dëshmive nga Njësia e Forenzikës, e datës 18.07.2024; procesverbali për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm, i datës 18.07.2024, me numër rasti 2024-AE-0836; Raporti i ekspertizës nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me numër referues AKF/2024-2607/24-2484, i datës 22.08.2024 lidhur me ekzaminimin e substancës narkotike dhe foto dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës në të cilin shihen substancat narkotike të sekuestruara nga tani i akuzuari, me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kështu që, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit si më lart ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale si më lart, si dhe vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pastaj të akuzuarin e shpalli fajtor, pasi që gjeti se është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që, ndaj të akuzuarit, gjykata mori në konsideratë rrethanën lehtësuese pranimin e fajësisë nga i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës dhe propozimi për prokurorinë për të hyrë në negociatë për marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe sjellja e të akuzuarit para dhe pas kryerjes së veprës penale, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar faktin se i akuzuari Q.B., është proceduar penalisht me aktgjykimet P.nr.302/2023 i plotfuqishëm me 28.08.2023 dhe P.nr.1737/2020 i plotfuqishëm me 08.03.2024, për vepra penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 i KPRK, sipas të cilave i njëjti është dënuar me gjobë, vepër penale kjo që hyn në kapitullin e veprave penale të narkotikëve, derisa rrethanë të tillë e ka marrë parasysh shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të akuzuarit në kryerjen e veprës penale dhe intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, sepse me vënien në qarkullim të narkotikëve të rrezikshëm rrezikohet shëndeti dhe jeta e qytetarëve të cilët konsumojnë këto substanca.

Andaj, gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të

cilën është shpallur fajtor, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar atij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK, përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Në këtë rast, gjykata është bazuar edhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, për një proces të hapur dhe të rregullt, që çdo person i akuzuar ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, duke pasur parasysh edhe bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij, si dhe në parimin që çdo person i akuzuar për një vepër penale të prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Për llogaritjen e masës së paraburgimit në dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit, është vendosur konform dispozitës së nenit 79, par. 1 të KPRK.

Vendimi që të akuzuarit t'i konfiskohen sendet – substancat narkotike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, u mor në bazë të dispozitës së nenit 267, par. 5 të KPRK, pasi që të njëjtat janë përdorur për kryerjen e veprës penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 452, par. 1 të KPP, ndërsa vendimi mbi taksën për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të neneve: 3; 6 dhe 39, par. 3.2 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lart dhe në bazë të neneve 267 par. 1 dhe 5 të KPRK, si dhe nenit 364 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 20.09.2024.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.171/2024, datë 18.09.2024.

Bashkëpunëtore profesionale,
Arbenita Hoxha Koleci

Kryetari i trupit gjykues,
Naser Foniqi

UDHËZIMI PËR MJETET JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar **brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh**, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.